




Nga Hans-Joachim Lanksch

Që në fillim duhet me ju rrëfye dy gjana: prej meje nuk mund të pritni një kumtesë shkencore, mbasi nuk jam njeri i shkencës, por i praktikës – një qytetar i thjeshtë që punon me gjuhën shqipe. E dyta: unë jam një dashamirës i madh i gegnishtes, ama jam edhe një dashamirës i madh i tosknishtes. Gjuha e Mjedës, Koliqit e Camajt asht e ambël dhe e pasun, ama po aq e bukur dhe e pasun asht gjuha e Naimit, Lasgushit e Mitrushit.

Vjetëve të fundit asht gjallnue diskutimi rreth gegnishtes resp. rreth raportit të saj me shqipen standarde, dhe, lidhun me këtë, debati rreth rishikimit të shqipes së standardizuese.

Kam disa, ma saktë: 6 kërkesa ndaj atyne që merren me debatin në fjalë:

- Diskutimi për gegnishten dhe standardishten e sotme duhet liberalizue, duhet me i dhanë fund monopolizimit të këtij kuvendimi nga ana e disa gjuhëtarëve që e mbrojnë standardishten e Kongresit të Drejtshkrimit dhe orvaten me uzurpue çdo diskutim për këtë çështje, ku përjashtohen sidomos shkrimtarët, ata pra që e përdorin dhe e krijojnë gjuhën.

Gjuhën e Dantes dhe Petrarkës s’e kanë krijuë gramatikanët, por Danteja dhe Petrarka. Me fjalë të tjera: nuk ban që për problemet e këndimit operistik të monologizojnë profesorët e kantos tue ua kyçë gojën kangëtarëve.

- Duhet me i dhanë fund diskriminimit të gegnishtes letrare si “dialekt”. Asht e vërtetë që ekzistojnë të folmet geqe me nëndialektet, nën-nëndialektet dhe nën-nën-nëndialektet etj. të tyne, por asht e vërtetë edhe se autorë si Migjeni a At Anton Harapi kanë shkruë një gegnishte letrare edhe pse ajo s’ka kenë e standardizuese.

- Diskutimi për gegnishten dhe gjuhën zyrtare letrare duhet shliurë prej vështrimeve jashtëgjuhësore. Gjuha nuk mund t’i nënshtrohet një qasje ideologjike, sidomos jo një qasje politike. Dihet që në djepin e gjuhës së dekretueme prej Kongresit të Drejtshkrimit qëndronin pikëpamje kryekëput politike që s’kishin me bënë asgjë me çështjen e gjuhës. Po citoj: “gjuhë letrare, gjuhë e përbashkët kombëtare duhet të jetë ajo e masave të popullit që përfaqësojnë

pjesën më progresive të vendit tonë”, u deklarue më ’47-ën, dhe 5 vjet ma vonë, në sesionin shkencor me titull “Veprat e shokut Stalin mbi gjuhësinë dhe problemet tona gjuhësore në dritën e këtyre veprave” u tha se: “juga nxori udhëheqësit kryesorë e më të shumtë të lëvizjes, ajo i dha kuadrot më të shumta”, ndërsa gegnishtja u shpall “reaksionare”. Në Kongresin më ’72-ën dhe mbasandej theksohej pandërprë që vlera e standardit qëndronte te “parimet marksiste”.

Diskutimi dhe trajtimi i gegnishtes dhe standardishtes duhet dezinfektue prej ngjitjeve të tilla e të ngjashme jashtëgjuhësore.

- Poashtu, debati për gegnishten dhe standardishten duhet shkuruar prej emocioneve dhe frazave bombastike e patetike.

Gegnishtja duhet të çmitologjizohet dhe standardi duhet të demistifikohet.

Ithtarët e gegnishtes duhet me u dhanë lamtumirën shprehjeve si “gegnishtja e shëjtë”, “lahuta ilire këndonte gegnisht” etj.

Avokatët e standardit duhen me u distancue prej shtrembnimeve faktesh. Disa mbrojtës të gjuhës së sotme zyrtare shqipe pretendojnë se gjuha e Kongresit të 72-ës na ishte një si arritje aspiratash shekullore të popullit shqiptar për një gjuhë të përbashkët letrare.

Kjo nuk asht e vërtetë.

Siç dihet mirë dhe shpesh harrohet me gjithë qejf, orvatjet dhe aspiratat e shqiptarëve për një gjuhë të përbashkët letrare rezultojnë në vendimet konsensuale të Komisionit Letrare të Shkodrës, në gegnishten jugore elbasanase. Elbasanishtja që një idiomë e gjallë, që mund të përdorej pa telashe të mëdha si prej tosknishtfolësve ashtu dhe prej gegnishtfolësve. Elbasanishtja si normë e shqipes nuk funksiononte në të gjitha nivelet. Një pjesë të fajit për këtë kanë edhe shkrimtarët të njohur që e injoronin modelin e elbasanishtes, ndër ta edhe At Gjergj Fishta, përndryshe anëtar i Komisionit Letrare të Shkodrës, i cili me kryeneçësi prej gegit vazhdonte me shkrue një gegnishte veriperëndimore.

Pushteti komunist, në vend që të angazhohej për afirmimin e gjuhës letrare të përcaktueme prej Komisionit Letrare të Shkodrës, e dekretoi tosknishten dhe e ndiqte me ngulm e dhunë përdorimin e saj si gjuhë zyrtare e cila mbas konsultave të shumta më 72-ën rezultoi në krijesën artificiale të gjuhës së njësuar letrare shqipe, një përzierje të çuditshme jo-organike tosko-gege.

- Përdorimi i standardit duhet liberalizue. Romancieri, poeti dhe publicisti Dr. Agron Tufa asht ankue disa herë në media shqiptare që redaktorët ia ndalojnë dhe shlyejnë edhe më të voglin devijim nga standardi. Kjo praktikë e mumifikon gjuhën dhe pengon çdo zgjanim dhe zhvillim, madje dhe frymëmarrjen e organizmit të gjallë që e quejmë gjuhë.

- Standardi nuk duhet fosilizue. Dihet se në bashkëpunim ndërakademik janë krijuar komisione të ndryshme të “Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe” për shikimin dhe rishikimin e shqipes standarde. Lutja ndaj anëtarëve të Këshillit e ndaj të gjithë të tjerëve që merren me rishikimin e standardit asht – mos me u kënaqë me retushime të vogla, mos me u marrë me

arnime, por me përmirësime e kurime të vërteta. Retushimet vetëm e vazhdojnë petrifikimin e standardit. Për t'iu shmangë diglosisë duhet me marrë para sysh edhe realitetin gjuhësor të shqipes në të shkruemit e të folurit, ku mundem me veçue sidomos, fjala vjen, çâshtjen e paskajores e cila përdoret prej dy të tretave të viseve shqipfolëse.

Disa fjalë për statusin quo. Në Kosovë de facto ekziston gjendja e diglosisë. Përveç kësaj, kur orvaten me e përdorë standardin, shumica dërrmuese e popullatës atë nuk e zotnojnë. Në Shqipëri, një pjesë e mirë e toskëve e përdorin tosknishten në vend të standardit, gjë që mund të vërehet mjaft mirë në radio e televizion, përderisa një pjesë e mirë e gegëve nuk e zotnuekan më plotësisht gegnishten dhe përdorin një mish-mash gego-standardisht.

U kam bërë pyetje me shkrim disa shkrimtarëve të Gegnisë se pse shkruajnë standardisht dhe jo gegnisht. Disa syrësh u përgjigjën në mënyrë bukur specifike dmth. fare, ndërsa disa të tjerë më kthyen përgjigje interesante dhe fort informative. Po citoj disa prej tyre:

- Mimoza Ahmeti që babain e ka prej Malit të Zi, shkruen:

"Akomodimi dhe funksionimi me sistemin ku jetoj që është administrator e funksional nuk më përkrah në të folurën e veriut. Poashtu gradualisht të folurit normativ iu vesh mentalitetit tim dhe tani është e vështirë të zbërthehet. Por potencën e gjuhës veriore jo vetëm nuk e mohoj por e adhuroj."

- Autori shkodran Stefan Çapaliku përgjigjet:

"Kam shkruar në gjuhë letrare sepse nuk kam pasë një model të gegnishtes letrare. Ma vonë kam shkruar edhe në gegnisht. Dramën e fundit e shkruajta në gegnisht dhe e vuna në skenë në Shkodër. Në teatër provova se gegnishtja tingëllonte për bukuri."

- Një autor tjetër shkodran, Gazmend Krasniqi, prozator, poet dhe eseist, që e quën veten autor gegnishtfolës dhe standardshkrues thotë ndër të tjera:

"I takoj një brezi që, kur ka filluar të shkruajë e të lexojë (bahet fjalë për Abetaren) asht "bombardue" në mënyrën më të rreptë nga e quejtuna Gjuhë e Njësuar." Në përgjigjen e tij më të gjatë, autori thekson që gegnishtja nuk mirëpritet nga editoria kështu që një shkrimtar serioz nuk mundet me ekzistue pa mbështetjen e domosdoshme të botuesve. Krasniqi shton: "Besoj që sot shtrohet pyetja se çfarë duhet bërë për ta rrejtun nga ekskomunikimi apo për të lidhë fjetet e zhvillue një traditë të konsolidueme, siç asht gegnishtja, me një mundësi që e jep një kohë demokratike si kjo e jona."

- Shkrimtari Ridvan Dibra, shkodran dhe ai, shkroi shqip e troç, siç e ka zakon: "nuk di me e shkru mirë gegnishten, për kto arsye:

1. Jam formu e kulturu me një vepër të shkruar apo të përkthyer toskërisht (shkolla, realizmi i mbrapshtë socialist, media etj);

2. Mungon hala një gramatikë e unifikueme e gegnishtes, sidomos asaj të stadit të sotëm;

3. Ndoshta një dëshirë disi e fshehtë për ta shtri hapsinën e komunikimit edhe ndë toskëri...”

Mundemi me përmbledhë përgjigjet e miqve të mi shkrimtarë: gegët e Shqipnisë janë rritë e rriten me standardishten dhe janë mësue me të. Mungesa e një norme gjuhësore të gegnishtes së sotme e vështirëson më tej përdorimin e një gegnishte letrare. Shumëkush përmllohet për bukurinë e gegnishtes.

Sa i përket gegnishtes – çka me bâ? Linguocidi që e ndërmori sistemi komunist ndaj gegnishtes asht ireversibël. Tash për tash, krijimi i një norme të përbashkët geqe duket me kenë iluzion, sidomos për shkak të bajraktarizmit të njohun notor, por edhe në mungesë të strukturave të nevojshme organizative, administrative e shkencore.

Duhet me i dhanë fund demonizimit të gegnishtes si element antikombëtar, anmik i popullit shqiptar, armë e përçarësve të kombit shqiptar etj. Botimi dhe distribuimi i librit në gegnishte duhet me u bâ edhe në jug të Shkodrës e Lezhës.

Sa i përket standardit – statusi ante quo sot nuk mundet me u vendosë, nuk mundet me u rivendosë norma e elbasanishtes. Gjuha e sotme zyrtare letrare duhet me u lirue nga korseja e një standardi të ngurosun. Duhet lejue zhvillimi organik i gjuhës, ku standardi i bazuem mbi tosknishten ka me u shkrî me elemente geqe. Kultivimi i gegnishtes letrare dhe liberalizimi i standardit nuk duen me thanë dhe nuk synojnë divergjencën por konvergjencën e natyrshme të idiomave shqipe./albanianpride.com/